



Nr. 1043/1 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Tiranë, më 12/04 /2025

V E N D I M

Nr. 16, datë 17.04.2025

P Ë R

MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, PROPOZUAR PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI MJEDISI, TË RIORGANIZUAR, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, VKM 112, datë 23.02.2018, e ndryshuar, Urdhërit të MAS Nr. 178, datë 04.04.2022, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së dhe kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.04.2025,

VENDOSI:

Të miratojë projektet kërkimore shkencore me titull:

1. Analizë e shkarkimeve nga burimet pikësore dhe ato difuze në basenin ujqor Ishëm-Erzen;
2. Integrimi i Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë (ZBN) për menaxhimin e ndryshimeve klimatike dhe roli i planifikimit urban Rast studimor: Prishtinë, Republika e Kosovës;
3. Vlerësimi i rrezikut nga erozoni në zona pyjore dhe përcaktimi i masave parandaluese;
4. Studim mbi strukturat e përbëra çelik-beton me përdorimin e betonit me agregate natyrore dhe të ricikluara;
5. Përdorimi i CPT në analizat mjedisore në zonën ndërmjet grykëderdhjes së lumenjve Seman dhe Shkumbin.

Propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Inxhinieri Mjedisore, të riorganizuar, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2025-2026.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo